

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit shpall vendet e punës për 3 (tre) punonjës kërkimorë me kohë të plotë pranë Departamentit të Sizmologjisë, si më poshtë:**

**1 (një) punonjës kërkimor-shkencor profili "Inxhinieri Kompjuterike dhe Sisteme Informatike".**

1. Të këtë formim universitar (Bachelor dhe Master i Shkencave) ose/dhe studime doktorate në Inxhinieri Kompjuterike dhe në Sisteme Informatike.
2. Nota mesatare (Bachelor + Master i Shkencave) mbi 8:00.
3. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë kryer formimin universitar dhe/ose shkollë doktorate jashtë vendit.
4. Njohuri të shëndosha në fushat e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, sistemet kompjuterike (Windows dhe Linux), dhe gjuhët e programimit (C/C++, Java), menaxhim rrjetesh kompjuterike, ndërtim dhe administrim të bazave të të dhënave, inxhinieri software-sh etj.
5. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë publikime në revista shkencore ose/dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda/jashtë vendit.
6. Eksperiencë pune në fushat e sipërpërmendura.
7. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse.

**1 (një) punonjës kërkimor-shkencor specialiteti "Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist".**

1. Të këtë formim universitar (Bachelor dhe Master i Shkencave) ose/dhe studime doktorate në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist.
2. Nota mesatare mbi 8.0.
3. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë kryer formimin universitar dhe/ose shkollë doktorate jashtë vendit.
4. Të këtë eksperiencë pune në fushën përkatëse.
5. Të këtë njohuri për analizat dhe historitë kohore të lëkundjeve të forta të tërmeteve.
6. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë publikime në revista shkencore ose/dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda/jashtë vendit.
7. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse.

**1 (një) punonjës kërkimor-shkencor profili "Fizikë".**

1. Të këtë formim universitar (Bachelor dhe Master i Shkencave) ose/dhe studime doktorate në Fizikë.
2. Nota mesatare (Bachelor + Master i Shkencave) mbi 8:00.
3. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë kryer formimin universitar dhe/ose shkollë doktorate jashtë vendit.
4. Përbëjnë avantazh kandidatët që kanë publikime në revista shkencore ose/dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda/jashtë vendit.
5. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse.

**DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **11.12.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.